

**KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME**  
**(Lloji kuota)**

Sot në Elbasan, më datë 08/01/2022, palët nënshkruajnë këtë kontratë si më poshtë vijon:

**SHITËSI:** 1) Altin Broshka i biri i Saliut i datëlindjes 28/02/1983, lindur në Mollas dhe banues në Greqi mbajtës i pasaportës nr. BR5671515 dhe numer personal I30228020K madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i 1 kuote kapitali (50% e kapitalit) të shoqërisë Euromontana sh.p.k. me NUIS **L73104204A**;

2) Konstantinos Karavelas i biri i Panajotis i i datëlindjes 15/08/1958, lindur në Zakynthos (Greqi) dhe banues në Greqi mbajtës i pasaportës nr. AT2175638 madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i 1 kuote kapitali (50% e kapitalit) të shoqërisë Euromontana sh.p.k. me NUIS **L73104204A**;

**Të 2 këta së bashku më poshtë të referuar si Pala Shitëse;**

**BLERËSI:** Syrja Halili, i biri i Bejazit i datëlindjes 03/07/1997, lindur në Godolesh dhe banues ne Godolesh, Elbasan, mbajtës i kartës së identitetit Nr. 033167074 dhe numër personal J70703015H, lëshuar më datë 28.07.2016 madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **më poshtë i referuar si Pala Blerëse;**

**Pala Shitëse dhe Pala blerëse, të dy së bashku do të quhen "Palët".**

**Të përgjithshme**

1. Pala shitëse **Altin Broshka & Konstantinos Karavelas** janë zotërues të 2 pjesëve me vlerë 10000 (dhjetmijë)Leke, që përbën 100% të kapitalit të Shoqërisë "EUROMONTANA" sh.p.k
2. Shoqëria është rregjistruar pranë QKB-së si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër nipt-i **L73104204A**, me objekt kryesor: 1. Eksport – import i imputeve bujqësore si dhe tregtimi i tyre me shumicë dhe pakicë; eksport – import i farërave bujqësore si dhe tregtimi i tyre me shumicë dhe pakicë; kryerja e zbatimit të punimeve të ndërtimeve civile dhe industriale; tregtimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme; eksport – import i materialeve të ndërtimit si dhe tregtimi i tyre me shumicë dhe pakicë; tregtimi i paisjeve elektrike dhe elektroshtëpiake; tregtimi i materialeve hidraulike dhe hidrosanitare; tregtimi i veglave të punës, paisjeve dhe makinerive; shfrytëzimi dhe përpunimi i materialeve inerte; shfrytëzimi dhe përpunimi i mermerëve dhe gurëve dekorativë; prodhimi i hidrosanitareve dekorative; tregtimi i produkteve ushqimore të konfeksionuara dhe të freskëta; catering; përpunimi dhe tregtimi i lëndës drusore; përpunimi dhe tregtimi i mobiljeve; tregtimi i pjesëve të këmbimit; prodhimi dhe tregtimi i konfeksioneve; eksport – import; studio projektuese; konsulencë teknike; joint-venture; franchising. 2. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimtaritë tregtare dhe industriale, që do të jenë të nevojshme dhe të dobishme për përmbushjen e objektit të shoqërisë, mund të lëshojë garanci reale ose personale edhe në favor të të tretëve, mund të zotërojë, mund të blejë ose të shesë kuota, aksione, ose obligacione të shoqërive të tjera tregtare private ose publike, mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, bankare, aktive dhe pasive, të domosdoshme që në mënyrë direkte apo indirekte ndihmojnë në realizimin e objektit themeltar të shoqërisë. Kapitali i shoqërisë është 10000 (dhjetmijë) lekë.
3. Pala shitëse i shet Palës Blerëse 2 pjeset (100%), nga 100% që zotëron në këtë shoqëri; në këto kushte Pala blerëse behet pronare e 100% të 2 pjesëve, dhe pas kalimit të kuotave blerësi bëhet pronar i shoqërisë, si më poshtë vijon:



Syrja Halili i cili do të jetë dhe Administrator i shoqërisë, rol i mbajtur më parë nga Z. Altin Broshka, i cili ia kalon këtë rol blerësit z. Syrja Halili

Në përputhje me nenin 117 pika b "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare », neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë "Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e shitjes", dhe në përgjithësi të legjislacionit shqiptar në fuqi, hartohet kontrata e shitjes së kuotave si më poshtë vijon:

4. Në përputhje me "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", sipas Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare » i ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë "Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e shitjes", hartohet kontrata e shitjes si më poshtë vijon:

#### Neni 1 Objekti

- 1.1 Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, Pala shitëse i kalon nëpërmjet shitblerjes 100 % me 2(dy)kuota nga kapitali i zotëruar në shoqëri si dhe të drejtën e pronësisë mbi kuotat dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje Palës Blerëse, duke e garantuar plotësisht titullin e pronësisë të pa rënduar me barrë dhe Pala blerëse nga ana tjetër blen nga Pala Shitëse kuotat kundrejt një çmimi të përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate.

#### Neni 2 Çmimi i Shitjes

Çmimi i shitjes është 10000(dhjetë mijë) leke, sa vlera e kapitalit të shoqërisë.

#### Neni 3 Pagesa

Çmimi është paguar nga Pala Blerëse jashtë zyrës noteriale.

#### Neni 4

##### Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitësi te Blerësi do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe depozitimim e kontratës në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

#### Neni 5 Garancitë

Pala shitëse në lidhje me kuotat që zotëron, garanton Palën Blerëse:

5.1. Se është pronar i vetëm i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e shitura.

5.2. Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.

5.3. Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.

5.4. Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së Kuotave, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme e shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

**Neni 6  
Regjistrimi**

Regjistrimi i kalimit të kuotes do të kryhet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 7  
Ligji i zbatueshëm**

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

**Neni 8  
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITESI**

- 1) Altin Broshka 
- 2) Konstantinos Karavelas 

**BLERESI**

Syrja Halili

